



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 241, Datë 30.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 13, DATË
16.01.2025 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100
MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr.116/4 prot., datë 26.09.2025 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 06.01.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhënat mbi shoqërinë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13, datë 16.01.2025, ka licencuar shoqërinë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 100 MW, i ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 1451, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afatë 30 -vjeçar.
- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE ka vendosur: 2. Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të depozitojë në ERE, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit. 3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.10.2027. 4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 2 dhe 3.

2. Kërkesa e shoqërisë dhe dokumentacioni i depozituar

- Shoqëria “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k., me shkresën e datës 23.09.2025, protokolluar në ERE me nr. 116/3 prot., datë 23.09.2025, ka depozituar marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik “Sunny Side Solar Park”, nënshkruar mes shoqërisë OST sh.a. dhe “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. me nr. 2921/3 prot., datë 19.06.2025 dhe ka kërkuar rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, në kuadër të plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
- Referuar raportit periodik lidhur me prodhimin e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, të dërguar nga OST sh.a. për muajin gusht 2025, rezulton se sasia e enrgjisë elektrike bruto e prodhuar nga impianti fotovoltaik “Sunny Side Solar Park” për muajin

gusht është 745.2 MWh, pra evidentohet se shoqëria ka hyrë në prodhim përpara depozitimit të kësaj marrëveshje, në funksion të përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 13/2025.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në funksion të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k., lidhur me rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, për plotësimin e kushteve të përcaktuara në vendim, vlerësohet se:
 - Kushti i përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi është plotësuar me depozitimin e marrëveshjes të nënshkruar mes shoqërisë OST sh.a. dhe shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k., si i tillë duhet të shfuqizohet.
 - Në përputhje me nenin 9 të Kontratës nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria duhet të pajiset me lejet përkatëse, të ndërtojë dhe të vendosë në operim centralin brenda datës 30.10.2027. Sipas raportimit periodik të dorëzuar, rezulton se shoqëria ka hyrë në prodhim, duke përmbushur kushtin në pikën 3 të vendimit, prandaj duhet të shfuqizohet.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në funksion të sa parashtuar më sipër, rezulton se kushtet e vendosura në pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025 janë plotësuar dhe duhet të shfuqizohen.
- Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se: *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 2 dhe 3”*. Për sa më sipër shpjeguar, duke plotësuar kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të vendimit, për rrjedhojë pika 4 e vendimit duhet shfuqizuar pasi nuk mbeten më kushte të tjera ndaj shoqërisë.
- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësojmë që pikat 2, 3, dhe 4 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, duhet të shfuqizohen pasi shoqëria “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. ka përmbushur kushtet e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2, 3 dhe 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

